



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERËT PUBLIKË**

Nr. 401/5 prot.

Tiranë, më 2.8.2019

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 162, datë 19.6.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit znj. Manjola Kajana
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5, i Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, në datë 22.7.2019, është njoftuar vendimi nr.162, datë 19.6.2019, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin në rivlerësim znj. Manjola Kajana, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2 të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 të ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor, nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, unë, Komisioneri Publik Florian Ballhysa, ushtroj ankim ndaj vendimit nr. 162, datë 19.6.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

**I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit**

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Manjola Kajana, ushtron detyrën e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë dhe, në zbatim të nenit 179/b,

pika 3 e Kushtetutës, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*. Subjekti është kandidat për Strukturën e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK).

2. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni), ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, si Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI), raportin e vlerësimit të figurës nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) dhe raportin e vlerësimit profesional nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP), nga të cilat rezultojnë se:
  - 2.1 **ILDKPKI**, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “*Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë për subjektin Manjola Kajana*”, ka referuar se:
    - i. *Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
    - ii. *Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
    - iii. *Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
    - iv. *Nuk ka kryer deklarim të rremë;*
    - v. *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*
  - 2.2 **DSIK**, bazuar në nenin 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, me anë të raportit mbi kontrollin e figurës, ka referuar: “*Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës*” për subjektin Manjola Kajana.
  - 2.3 **KLP**, bazuar në nenin 43, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt rivlerësimi, ka përcjellë pranë Komisionit raportin për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit znj. Manjola Kajana.
3. Komisioni, pas hetimit administrativ dhe vlerësimit të fakteve dhe rrethanave lidhur me kontrollin e pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, për secilin kriter, në mënyrë të përmbledhur, ka arritur në përfundimet si vijon:
  - 3.1 ***Për vlerësimin e pasurisë.*** Lidhur me kriterin e pasurisë nën hetimin e thelluar e të gjithanshëm, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar me vërtetësi dhe saktësi deklaratën “*Vetting*” dhe ka pasur burime të ligjshme për të justifikuar pasuritë, në përputhshmëri të plotë me deklaratimet periodike, si dhe të mbështetur në dokumentacion ligjor që në momentin e dorëzimit të deklaratës “*Vetting*” në ILDKPKI, sipas nenit D të aneksit të Kushtetutës, si dhe ligjit nr. 84/2016.
  - 3.2 ***Për kontrollin e figurës.*** Për kriterin e kontrollit të figurës, trupi gjyqës, në konsideratë të verifikimit e konfirmimit nga institucionet përgjegjëse për përshtatshmëri në detyrë, edhe pas hetimit të thelluar, vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Manjola Kajana, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.
  - 3.3 ***Për vlerësimin e aftësive profesionale.*** Për kriterin profesional, trupi gjyqës, referuar aneksit të Kushtetutës (neni E), ligjit nr. 84/2016 (kreu VI), vlerëson se subjekti ka përmbushur kushtet ligjore të pikës “c”, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

4. Nisur nga përfundimet e mësipërme për secilin kriter kontrolli, bazuar në nenin 55, pika 5, nenin 58, pika 1, germa “a”, si dhe në nenin 59, pika 1 dhe 4<sup>1</sup>, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka vendosur:

*i. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Manjola Kajana, me funksion prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë.*

## **II. Vlerësimi i Komisionerit Publik**

5. Në zbatim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet që kryejnë procesin e rivlerësimit kalimtar (Vetting).
6. Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisioneri Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit, pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim referuar si Kolegji).
7. Në krahasim me kompetencat kushtetuese dhe ligjore që u njihen Komisionit dhe Kolegjit nga neni Ç, i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48 – 52, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit.
8. Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, në gjendjen që janë aktet, duke vlerësuar nëse vendimmarrja është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave në zbatim dhe të parimit të respektimit të barazisë përpara ligjit, në funksion të garantimit të një procesi të rregullt gjyqësor.
9. Komisioneri Publik vlerëson se në shqyrtimin e akteve të këtij vendimi, për shkak të rrethanave të njëjta të faktit dhe ligjore, duhet t’i referohet edhe qëndrimin të mbajtur në ankimin kundër vendimit nr. 84/2018 të Komisionit, për të cilin është depozituar dhe një rekomandim nga ana e një komisioni prej tre vëzhguesish ndërkombëtarë të ONM-së. Në aktet e sipërcituara, për një situatë të ngjashme të një subjekti tjetër rivlerësimi, është arritur në përfundimin se shihet e pamundur konfirmimi në detyrë i subjektit të rivlerësimit, duke argumentuar se çështjet të cilat potencialisht dëmtojnë besimin e publikut, duhen vlerësuar drejt, duke i trajtuar brenda kuadrit të vlerësimit tërësor të procedurave, siç parashikohet në nenin 61, pika 5, dhe nenin 4, pika 2, e ligjit nr. 84/2016.
10. Në rastin konkret, Komisioneri Publik, mbështetur në kompetencën e tij ligjore, nga shqyrtimi i arsyesimit të vendimit nr. 162, datë 19.6.2019, dhe i akteve të administruara në dosjen e Komisionit, vlerëson se provat e marra gjatë hetimit administrativ nuk janë të mjaftueshme

---

<sup>1</sup> Komisioneri Publik konstaton se baza ligjore e cituar nga Komisioni nuk përputhet me përmbajtjen e dispozitivit të vendimit, konkretisht neni 59, pika 4, i ligjit nr. 84/2016, pasi në dispozitiv të këtij vendimi nuk është evidentuar asnjë rast që mund të përbëjë shkelje disiplinore të subjektit të rivlerësimit, për t’u transferuar pranë organit kompetent për inspektim.

për të vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, bazuar në vlerësimin tërësor të procedurave, duke çmuar se ky vendim shfaq mangësi në hetimin administrativ.

11. Ky ankim i Komisionerit Publik në rastin konkret parashtron dhe evidenton mungesën e hetimit mbi rrethana të tilla dhe fakte ligjore, si: (i) ligjshmëria e aplikimit të përfitimit të statusit si i pastrehë, në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane” (të ndryshuar), në raport me integritetin e subjektit, në përmbushje me standardet më të larta etike, si gjatë ushtrimit të detyrës, ashtu dhe në jetën private; (ii) deklaratimet e pasakta dhe kontradiktore të subjektit të rivlerësimit në plotësimin e *Deklaratës për kontrollin e figurës, sipas shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016, pjesa 2*, si dhe deklarimeve të vetë subjektit, mbi historikun e vendbanimit dhe vendqëndrimit të saj dhe familjes; (iii) gjendja e mundshme e konfliktit të interesit midis subjektit të rivlerësimit dhe funksionit të magjistratit/prokurorit, në drejtim të përfitimit të një trajtimi preferencial, në kuptim të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” (të ndryshuar); si dhe (iv) mungesë hetimi mbi çështje të tjera të lidhura me burimet e ligjshme të të ardhurave të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të.
12. Rezultatet e hetimit nga ana e Kolegjit, mbi këto rrethana të ndërthurura me njëra-tjetrën, që lidhen më të tria kriteret e rivlerësimit, eventualisht do të provonin nëse *veprimet apo mosveprimet* e subjektit të rivlerësimit kanë cenuar rregullat etike profesionale, figurën e magjistratit apo nëse subjekti i rivlerësimit ka pasur ose jo burime të ligjshme të të ardhurave dhe, në vlerësim tërësor të procedurave, do të mund të vendosej mbi vlerësimin përfundimtar për konfirmimin ose jo në detyrë të subjektit të rivlerësimit.

### III. Shkaqet e ankimit

13. Në deklaratën “*Vetting*” subjekti ka deklaruar: Apartament me sip. 110.11 m<sup>2</sup>, ndodhur në \*\*\*, Tiranë, blerë në vitin 2013, nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., në emër të \*\*\* dhe Manjola Kajana. Vlera: 43.100 euro. Pjesa takuese: 50 %. Si burim të krijimit të pasurisë, subjekti ka deklaruar: kursimet e realizuara nga paga e subjektit të rivlerësimit dhe e bashkëshortit të saj në vite dhe pjesërisht me kredi nga \*\*\*.
14. Nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ mbi burimin e deklaruar: *kredi e përfituar nga \*\*\*, në shumën 2.500.000 lekë*, ka rezultuar se:
  - 14.1 \*\*\* me shkresën nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.12.2018, ka konfirmuar se shtetasi \*\*\*.\*\*\* dhe subjekti i rivlerësimit janë bashkëkredimarrës pranë kësaj banke, të shumës 2.500.000 lekë, sipas aktit nr. \*\*\* rep./\*\*\* kol., datë \*\*\*.3.2014, “Ndryshime në kredinë bankare”.
  - 14.2 Kjo huadhënie bankare rezulton fillimisht e aprovuar me kontratën e kredisë nr. \*\*\* rep./ nr. \*\*\* kol., datë \*\*\*.6.2013, lidhur midis \*\*\*, dega Fier, dhe subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj. Objekt i kësaj kontrate ka qenë lëvrimi në favor të kredimarrësve të një totali kreditimi në shumën 2.900.000 lekë, si kredi lehtësuese me normë interesi 3%, bazuar në ligjin nr. 9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane” (të ndryshuar), dhe akte të tjera nënligjore.

- 14.3 Gjatë hetimit administrativ, në përgjigje të kërkesës së Komisionit<sup>2</sup>, rezulton se Bashkia Fier, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.6.2019, ka paraqitur pranë Komisionit kopje të vendimit nr. \*\*\*, datë \*\*\*.10.2012, të Këshillit Bashkiak të Bashkisë Fier, “Për miratimin e listës emërore të kredisë”, bashkëlidhur të cilit është lista emërore e familjeve të pastreha, që do të përfitojnë kredi më kushte lehtësuese, ku përfshihet dhe bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e kryefamiljarit.
- 14.4 Gjithashtu, nga praktika e bankës, e vënë në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit, rezulton se Bashkia Fier, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.12.2012, ka përcjellë pranë \*\*\* listën e miratuar me Vendim të Këshillit të Bashkisë nr. \*\*\*, datë \*\*\*.10.2012, ku figuron i listuar edhe bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. \*\*\*.\*\*\* në cilësinë e kryefamiljarit, i cili renditet i 60-ti, me përshkrimin: *“familje e pastrehë, jeton në banesë me qira, sipas udhëzimit nr. 6257, datë 2.9.2008”*<sup>3</sup>, me qëllim trajtimin e familjes me kredi lehtësuese.
- 14.5 Komisioni, në analizë të këtyre akteve, i ka kërkuar shpjegime dhe dokumentacion mbështetës<sup>4</sup> subjektit të rivlerësimit, e cila, pasi ka dhënë shpjegimet përkatëse, ka depozituar kopjen e praktikës dokumentare të kredisë, të vënë në dispozicion nga banka. Sa më sipër, rezulton se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 9232, datë 13.4.2004, “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, ka aplikuar në cilësinë e kryefamiljarit për kredi si familje e pastrehë në qytetin e Fierit.
- 14.6 Komisioni, për të qartësuar kushtet e aplikimit për përfshirjen në programet sociale të strehimit, i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit, duke konstatuar *“...se dukej se kishte aplikuar në kundërshtim me ligjin nr. 9232/2004, ‘Për programet sociale të strehimit për banorët e zonave urbane’, (të ndryshuar)... si dhe aktet e tjera dalë në zbatim të këtij ligji për të përfutur statusin ‘i pastrehë’, pasi njëkohësisht ajo ishte bashkëpronare me bashkëshortin dhe vjehrrin e saj në pasurinë e privatizuar nga Enti Kombëtar i Banesave në qytetin e Durrësit... dhe, për pasojë, dukej se subjekti kishte nënshkruar në kundërshtim po me këtë legjislacion edhe kontratën nr. \*\*\*, datë \*\*\*.5.2013, si dhe kontratën e hipotekimit nr. \*\*\*, datë \*\*\*.6.2013”*<sup>5</sup>.
- 14.7 Në përgjigjen e saj, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, është shprehur: *“...se banesa në qytetin e Durrësit, ku ajo ka qenë bashkëpronare së bashku me bashkëshortin dhe vjehrrin e saj, ka qenë një banesë me sipërfaqe rreth 40 m<sup>2</sup>, në të cilën bashkëshorti dhe prindërit e tij kanë jetuar për një kohë të gjatë kundrejt pagesës së një qiraje shtetërore. Në kohën e privatizimit të saj, në vitin 2012, atje jetonte vetëm i vjehrrin, ndërkohë që bashkëshorti, djali dhe vetë ajo kanë jetuar në shtëpi me qira, për shkak të sipërfaqes së vogël dhe gjendjes së amortizuar të banesës në bashkëpronësi në qytetin e Durrësit”*. Subjekti i rivlerësimit po ashtu pretendon se: *“...bashkëshorti i saj kujton se ka bërë kërkesë dhe ka dorëzuar dokumentacionin, duke çmuar se kishte të drejtë të përfitonte nga programet sociale që*

<sup>2</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.5.2019.

<sup>3</sup> Udhëzim “Mbi përcaktimin e masës së subvencionit për familjet që përfitojnë kredi të lehtësuara nga shteti”.

<sup>4</sup> Referohuni përgjigjeve të pyetjeve datë 16.5.2019, në tekst të email-it, si dhe dokumentacionit bashkëngjitur, në dosjen e Komisionit.

<sup>5</sup> Referohuni paragrafit të dytë, faqe nr.10, në vendimin e Komisionit.

*ofronte Bashkia e Fierit, sipas germës “b”, të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, në të cilën parashikohet se përfitues mund të ishin edhe familjet që “zotërojnë sipërfaqe banimi nën normat e strehimit të përcaktuara për atë kategori sociale””. Subjekti i rivlerësimit, në analizë përfundimtare të kësaj rrethane, shprehet se: “Ne nuk kemi përfituar kredinë sipas saj, si rrjedhojë, ajo nuk ka passjellë asnjë pasojë financiare apo juridike<sup>6</sup>”.*

- 14.8 Nga aktet e administruara rezulton se kredia nuk është disbursuar sipas kontratës së nënshkruar në datën \*\*\*.6.2013, për shkak të ezaurimit të kuotave të Bashkisë Fier për përfituesit nga programi i kreditimit me kushte lehtësuese nga shteti dhe, për pasojë, palët kanë pranuar të ndryshojnë kontratën e kredisë bankare datë \*\*\*.6.2013, me kontratën nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.3.2014, “Ndryshime në kontratën e kredisë bankare”, duke ndryshuar ndër të tjera shumën e kreditimit nga 2.900.000 lekë në 2.500.000 lekë, me afat 240 muaj, dhe normë interesi nga 3% në bono thesari vjetore, interes 3.8%.
- 14.9 Nisur nga provat e administruara gjatë hetimit administrativ dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, rezulton se Komisioni ka arritur në konkluzionin se: “...miratimi i kredisë në emër të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit është kryer konform parashikimit ligjor të VKM-së nr. 814, datë 3.12.2004, në të cilën, ndër të tjera, thuhet se përfitojnë kredi familjet që nuk disponojnë banesë në pronësi ose banojnë nën normat e strehimit. Në kushtet kur sipërfaqja e banesës së privatizuar në qytetin e Durrësit ka qenë më e vogël se ajo e duhur në proporcion me numrin e frymëve të anëtarëve të familjes së subjektit të rivlerësimit, edhe kredia ka qenë plotësisht e lejuar për t’u përfituar. Në përfundim, Komisionit i rezultoi se subjekti ka përfituar kredinë me norma të zakonshme interesi”<sup>7</sup>.
- 14.10 Komisioneri Publik vlerëson se konkluzioni i Komisionit nuk i përgjigjet gjendjes së akteve të administruara për këtë qëllim. Në analizë të rrethanave sa më sipër dhe kritereve ligjore, mbeten për t’u hetuar rrethanat, faktet ligjore lidhur me: (i) ligjshmërinë e aplikimit të përfitimit të statusit si i pastrehë në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004 (të ndryshuar), në raport me integritetin e subjektit, në përmbushje me standardet më të larta etike, si gjatë ushtrimit të detyrës, ashtu dhe në jetën private; (ii) deklaratimet e pasakta dhe kontradiktore të subjektit të rivlerësimit në plotësimin e *Deklaratës për kontrollin e figurës sipas shtojcës 3, të ligjit nr. 84/2016, pjesa 2*, si dhe deklaratimeve të vetë subjektit, mbi historikun e vendbanimit dhe vendqëndrimit të saj dhe familjes; (iii) gjendja e mundshme e konfliktit të interesit midis subjektit të rivlerësimit dhe funksionit të magjistratit/prokurorit, në drejtim të përfitimit të një trajtimi preferencial, në kuptim të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” (të ndryshuar).
- 14.11 Në vijim, Komisioneri Publik parashtron analizën e shkaqeve për të cilat Kolegji duhet të vendosë në zbatim të juridiksionit të tij kontrollues dhe rivlerësues, për sa kohë në vlerësimin

<sup>6</sup> Referohuni parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit datë 11.6.2019.

<sup>7</sup> Referohuni: “Arsyetimit ligjor të provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm”, faqe 11 e vendimit të Komisionit.

tërësor të procedurave mbetet i pajustificuar vendimi i Komisionit për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit.

## 15. Lidhur me ligjshmërinë e aplikimit për përfitimin e statusit si i pastrehë

- 15.1 Sikundër u parashtrua më lart, Këshilli Bashkiak i Bashkisë Fier, me vendimin nr. \*\*\*, datë \*\*\*.10.2012, ka miratuar listën emërore të familjeve të pastreha, të cilat kanë aplikuar për të përfituar kredi me kushte lehtësuese, listë në të cilën figuron edhe bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e kryefamiljarit.
- 15.2 Komisioneri Publik vlerëson të nënvizojë se, referuar ligjit nr. 9232/2004, konkretisht nenit 4 të tij, rezulton se përfitojnë strehim: (i) individët që kanë mbushur moshën 18 vjeç dhe (ii) familjet e regjistruara në zyrat e gjendjes civile në njësitë e qeverisjes vendore, të cilat, në momentin e aplikimit, plotësojnë kushtet e mëposhtme:
- a. nuk kanë në pronësi një banesë;*
  - b. zotërojnë sipërfaqe banimi nën normat e strehimit, të përcaktuara për atë kategori sociale dhe ekonomike, ku bëjnë pjesë këto familje, ose banojnë në banesa jashtë standardeve në fuqi;*
  - c. kanë mbetur të pastrehë, si rezultat i fatkeqësive natyrore;*  
*Përfshihen në një të një nga shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të pikës 1, të këtij neni vetëm ato familje që kanë të ardhura të pamjaftueshme.*
- 15.3 Lidhur me parashikimin ligjor se përfituesit nuk duhet të kenë banesë në pronësi, nga aktet e administruara në dosjen e Komisionit, rezulton se subjekti i rivlerësimit me aktin: “Kontratë shitje përfundimtare”, nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë \*\*\*.6.2012, lidhur midis Entit Kombëtar të Banesave (EKB), në cilësinë e shitësit, dhe vjehrrit, bashkëshortit dhe subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e blerësit, kanë fituar pronësinë mbi një apartament banimi në qytetin e Durrësit, me sip. 41,9 m<sup>2</sup>.
- 15.4 Komisioneri Publik, duke marrë në konsideratë edhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit<sup>8</sup> se: “...Bashkëshorti kujton se ka bërë kërkesë dhe ka dorëzuar dokumentacionin, duke çmuar se kishte të drejtë të përfitonte nga programet sociale që ofronte Bashkia e Fierit sipas germës ‘b’, të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004, të ndryshuar, ‘Për programet sociale për strehimin e banoreve të zonave urbane’, në të cilën parashikohej se përfitues mund të ishin edhe familjet që ‘zotërojnë sipërfaqe banimi nën normat e strehimit të përcaktuara për atë kategori sociale’”, konstaton se referuar VKM-së nr. 814, datë 3.12.2004, “Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit”, banesa në qytetin e Durrësit, në bashkëpronësi të vjehrrit, bashkëshortit dhe subjektit të rivlerësimit, është mbi normën e përcaktuar nga kjo VKM, në pikën 2 të saj<sup>9</sup>.

<sup>8</sup> Referohuni parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit, datë 11.6.2019.

<sup>9</sup> Sipërfaqja minimale e banimit që i takon një personi të vetëm, sipas shkronjës “a”, të pikës 1, të këtij vendimi, është 12,5 m<sup>2</sup>. Çdo person tjetër shtesë mbi të parin, me moshë mbi 10 vjeç, i takon 7,5 m<sup>2</sup> sipërfaqe banimi.

- 15.5 Ndërkohë, lidhur me parashikimin ligjor mbi kriterin e të ardhurave<sup>10</sup>, nga verifikimi i akteve të administruara në dosjen e Komisionit, rezulton se për vitin 2012, kohë kur është aplikuar dhe dorëzuar dokumentacioni justifikues për plotësimin e kriterëve, të ardhurat mesatare mujore të familjes Kajana (përfshirë edhe vjehrrin) janë në shumën rreth 232.000 lekë.<sup>11</sup> Gjithashtu, në emër të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj, nga të dhënat e sistemit bankar, rezulton se balanca (gjendje) e llogarive bankare të tyre në datën \*\*\*.10.2012, datë që përkon me datën e vendimit të Këshillit Bashkiak Fier, është në total në vlerën rreth 5.700.000 lekë.<sup>12</sup>
- 15.6 Referuar vërtetimit të punësimit të datës \*\*\*.10.2016, të lëshuar nga shoqëria “\*\*\*.\*\*\*.\*\*\*” sh.p.k, rezulton se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, nga viti 2011 deri në nëntor të vitit 2012, ka qenë i punësuar në Tiranë, pranë kësaj shoqërie. Vetëm për vitin 2012, vit i cili përkon me periudhën e aplikimit nga ana e tij në cilësinë e kryefamiljarit, për kredi me kushte lehtësuese si i pastrehë, të ardhurat e tij neto janë në vlerën 9.965 euro.
- 15.7 Përmbushja e kriterëve ligjore për të përfutur nga programet sociale për strehim, normohet në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 574, datë 29.8.2012<sup>13</sup>, në fuqi kur është miratuar Vendimi i Këshillit Bashkiak të Bashkisë Fier nr. \*\*\*, datë \*\*\*.10.2012. Sipas kriterëve të kësaj VKM-je, pas fazës së parë, që përfshin aplikimin nga ana e subjekteve që kërkojnë të përfitojnë, klasifikimit nëpërmjet sistemit të pikëzimit, seleksionimit të përfituesve, njoftimit, kalohet në fazën e dytë, ku familjet përfituese duhet të dorëzojnë dokumentacionin provues që mbështet aplikimin, ku, ndër të tjera, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në cilësinë e kryefamiljarit, duhet të ketë paraqitur këto dokumente:
- *certifikatën e lindjes së aplikantit dhe certifikatën e gjendjes familjare;*
  - *vërtetimin për vendbanimin në bashkinë ku kërkohet strehimi ose lejen e banimit, për familjet që kanë lëvizur nga zona të tjera të vendit;*
  - *vërtetimin e të ardhurave neto të familjes;*
  - *dokumentacionin përkatës nga punëdhënësi për detyrën dhe të ardhurat e aplikantit e të personave të tjerë të familjes, që janë në marrëdhënie pune;*

<sup>10</sup> Referohuni nenit 19, pika 3, e ligjit nr. 9232/2004 (të ndryshuar), dhe lidhjes “c” bashkëlidhur, “Mbi përcaktimin e kufirit maksimal dhe minimal të të ardhurave të familjes që përfitojnë nga banesat me kosto të ulët”.

<sup>11</sup> Të llogaritura bazuar në vërtetimin nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.10.2016, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Fier, mbi të ardhurat e subjektit në shumën 72.495 lekë; Vërtetim i datës \*\*\*.10.2016, i shoqërisë \*\*\*, mbi të ardhurat neto të realizuara nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit për periudhën janar – nëntor 2012, në shumën 116.025 lekë (të konvertuara me kursin mesatar vjetor); Vërtetimit për bazën e tatueshme dhe pagën neto vjetore të vjehrrit të subjektit të rivlerësimit, në shumën 43.483 lekë.

<sup>12</sup> Nga korrespondenca e Komisionit me bankat, rezulton shuma 2.000.000 lekë, vendosur në emër të subjektit të rivlerësimit, në bono thesari (vendosur në datë 1.8.2011 dhe rinovuar pas maturimit në datën 2.8.2012); shuma 21.005 euro ose 2.935.728 lekë (konvertuar me kursin e datës 30.10.2012), depozitë në \*\*\* Bank, në emër të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit; shuma 5.546 euro ose 774.061 lekë, gjendje në llogaritë e pagës së bashkëshortit pranë \*\*\* dhe \*\*\*.

<sup>13</sup> VKM e cila ka shfuqizuar VKM-në nr. 53, datë 28.1.2005, “Për përcaktimin e dokumentacionit të nevojshëm, afateve dhe procedurave për të përfutur strehim nga programet e banesave sociale me qira”.



- dokumentin nga organet tatimore dhe ato të sigurimeve shoqërore për derdhjen e kontributeve, për të gjithë anëtarët e vetëpunësuar të familjes;
  - vërtetimin nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme se familja apo ndonjë anëtar i saj nuk disponojnë në pronësi banesë a ndonjë mjedis, që mund të përdoret si e tillë;
  - vërtetimin nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme të vendit të origjinës, se nuk figuron e regjistruar asnjë pronë, e cila mund të përdoret edhe për strehim, për familjet që kanë ndryshuar vendbanim për efekt punësimi.
- 15.8 Në mungesë të administrimit nga ana e Komisionit të dokumenteve të paraqitura nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, në momentin e aplikimit pranë Këshillit Bashkiak të Bashkisë Fier, për përfshirjen në listën e përfituesve nga programet sociale për strehim, referuar sa është administruar gjatë hetimit administrativ të Komisionit, familja e subjektit të rivlerësimit rezulton përfituese e kësaj të drejte jashtë kritereve ligjore. Në këto rrethana, Komisioneri Publik vlerëson se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, se “...Ne nuk kemi përfituar kredinë sipas saj, si rrjedhojë, ajo nuk ka passjellë asnjë pasojë financiare apo juridike”, nuk janë të mjaftueshme për të konkluduar mbi ligjshmërinë e aplikimit dhe përfitimit të kësaj kredie.
- 15.9 Duhet të nënvizojmë se mungesa e finalizimit të marrëdhënies së kredisë me kushte lehtësuese me interes 3%, si dhe mungesa e pasojave juridike të pretenduara, kanë qenë të pavarura nga vullneti i subjektit të rivlerësimit apo bashkëshortit të saj, pasi ata vullnetin e tyre e kanë konkretizuar si me aplikimin për përfitimin e kësaj kredie, ashtu dhe me lidhjen e kontratës për përfitimin e kredisë. Vetë subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: “...Kjo kontratë nuk u ekzekutua nga ana e bankës, për shkak se siç na njoftoi banka, pas lidhjes së kontratës, Bashkia e Fierit nuk kishte më kuota në dispozicion për këtë kategori kredisë<sup>14</sup>”.
- 15.10 Në gjendjen që janë aktet në dosje, mbeten të paqarta rrethanat dhe faktet mbi dokumentacionin e paraqitur nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e kryefamiljarit, për përfitimin e kredisë me kushte lehtësuese, si i pastrehë, për sa kohë nuk plotësohen kushtet e mungesës së banesës në pronësi apo një banesë nën normat e lejuara dhe të ardhurat e tyre nuk janë në pajtueshmëri me kushtet ligjore të përfitimit të statusit si i pastrehë.
- 15.11 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, ashtu sikurse dhe Komisioni i ka kërkuar Bashkisë Fier, por pa marrë përgjigje shteruese të shoqëruar me dokumentacionin e kërkuar, do t'i shërbente hetimit administrativ nëse do të administrohej e gjithë praktika dokumentare për miratimin si përfitues i programeve sociale për strehim të z. Kajana, depozituar pranë Bashkisë Fier.
- 15.12 Komisioneri Publik, sa më sipër, vlerëson se: përfitimi jashtë kritereve ligjore të statusit si i pastrehë i familjes së subjektit të rivlerësimit, në qytetin e Fierit, ndërkohë që subjekti ushtronte funksionin e prokurores në këtë qytet, mund të jetë rrjedhojë e përfitimit të padrejtë

<sup>14</sup> Referohuni përgjigjeve të subjektit të rivlerësimit, në vijim të pyetjeve të Komisionit, të datës 16.5.2019.

për shkak të funksionit, si dhe e paraqitjes së rrethanave dhe fakteve ndryshe nga situata faktike, duke rënë ndesh me përmbushjen e standardeve të etikës profesionale. *Komisioneri Publik*, në ndryshim nga përfundimi i Komisionit, në gjendjen që janë aktet, nuk mund të vlerësojë nëse subjekti i rivlerësimit ka cenuar etikën e magjistratit (neni 61/4), e për rrjedhojë, në një vlerësim tërësor të kriterëve të rivlerësimit, besimin e publikut në sistemin e drejtësisë (neni 61/5).

## **16. Lidhur me deklaratimet kontradiktore të subjektit mbi vendbanimin dhe vendqëndrimin**

- 16.1 Subjekti i rivlerësimit, bazuar në nenin 35, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, ka plotësuar deklaratën për kontrollin e figurës sipas shtojcës 3, bashkëngjitur këtij ligji, së bashku me vetëdeklarimin se të dhënat e paraqitura janë të sakta dhe të vërteta, dhe se mosplotësimi i saktë dhe me vërtetësi i deklaratës për kontrollin e figurës mund të passjellë shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.
- 16.2 Ndërkohë, referuar **Deklaratës për Kontrollin e Figurës**, sipas shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016, pjesa 2, të dhëna për vendin e banimit, në rubrikën: *“historiku i adresave të banimit nga 1.1.2012, ku përfshihen dhe adresat e vendeve në të cilat ka jetuar për arsye studimesh/pune”*, subjekti ka deklaruar këtë historik: *“(i) 01/2012-07/2013 \*\*\*.\*\*\*, \*\*\*; Tiranë; (ii) 07/2013 - aktualisht rr. ‘\*\*\*’, \*\*\*; Tiranë”*. Nisur nga rrethanat që vetë subjekti ka deklaruar, nuk rezulton të ketë deklaruar saktësisht historikun e adresave, pasi subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar adresën e banimit në qytetin e Fierit.
- 16.3 Referuar **Raportit profesional të hartuar nga KLP-ja**, rezulton se subjekti i rivlerësimit, nga tetori 2009 - maj 2014, ka qenë e emëruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Fier. Ndërkohë gjatë kësaj periudhe ka qenë e komanduar nga: prill 2010 - shtator 2010 dhe shtator 2011 - shtator 2012, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Durrës; shtator 2013 - qershor 2014, këshilltare ligjore në Prokurorinë e Përgjithshme, ndërsa nga muaji maj 2014 e në vazhdim ka kryer detyrën e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda. Nga sa më sipër, rezulton se subjekti ka ushtruar në Fier funksionin e Prokurores vetëm në periudhat: *tetor 2009 - prill 2010 (7 muaj); dhjetor 2010 - shtator 2011(10 muaj); shtator 2012 - shtator 2013 (12 muaj)*.
- 16.4 **Në Deklarimet periodike vjetore (D. V.)**, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si në vijim:
- (i) Në D.V. para fillimit të detyrës të vitit 2008, subjekti ka deklaruar si adresë të gjendjes civile: L. \*\*\* Durrës, ndërsa si adresë banimi, rr. “\*\*\*.\*\*\*”<sup>15</sup>.
- (ii) Në D.V. 2008, subjekti ka deklaruar si adresë të gjendjes civile: L. \*\*\* Durrës, adresë kjo e deklaruar deri në D.V. 2011.
- (iii) Në D.V. 2012, subjekti ka deklaruar si adresë të gjendjes civile, L. “\*\*\*”, Fier.

<sup>15</sup> Subjekti ka sqaruar se: *“..kjo është adresa ku ndodhet apartamenti ku aktualisht jetojnë prindërit e mi, \*\*\* dhe \*\*\*.\*\*\*, dhe ku unë kam banuar me prindërit e mi nga viti 2000, kur është blerë kjo pronë e deri nga fundi i vitit 2009, kur kam filluar të jetoj në qytetin e Durrësit. Kjo adresë është deklaruar në deklaratën e vitit 2008, ‘para fillimit të detyrës’, pasi unë në atë kohë jetoja me prindërit”*. Referohuni përgjigjes së pyetësorit nr. 3, në fashikullin pyetësorët në dosje të Komisionit.

(iv) Në D.V. 2014 deri në D.V. 2017, subjekti ka deklaruar si adresë të gjendjes civile, L. nr. \*\*\*, rr. “\*\*\*.\*\*\*”, Durrës<sup>16</sup>, si dhe adresë banimi \*\*\*, pallati i \*\*\*, hyrja nr.\*\*\*, Kashar.

- 16.5 **Në përgjigje të pyetësorit nr. 1** të Komisionit, në mënyrë të përmbledhur, ka deklaruar këto vendbanime sipas periudhave: *“janar - shtator 2011, me qira në qytetin e Durrësit, shtator 2011 - korrik 2013, me qira në qytetin e Tiranës. Nëntor 2012 kam marrë me qira një apartament në qytetin e Fierit, për shkak se atje kisha vendin e punës. Në këtë kohë mbaj mend që kam bërë edhe transferimin e gjendjes civile në qytetin e Fierit.”*<sup>17</sup> *Ky apartament është përdorur disa muaj, pasi në vitin 2013 jam komanduar me punë në qytetin e Tiranës. Më pas, në korrik të vitit 2013, kam filluar të banoj në apartamentin ku banoj aktualisht me familjen, në zonën e \*\*\*, në Tiranë”*.
- 16.6 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të email-it të Komisionit, të datës 28.3.2019, e pyetur mbi kontratat e qirasë të banesave ku ka jetuar, ndër të tjera, ka shpjeguar se: *“...Në qytetin e Tiranës kemi qëndruar me qira në apartamentin e shtetasit \*\*\*,\*\*\*. ...Kontrata e qirasë me këtë shtetas është nënshkruar më datë \*\*\*.9.2011, kohë kur kemi filluar të jetojmë në këtë apartament të ndodhur në zonën e \*\*\*, deri në korrik të vitit 2013, kur kam shkuar të banoj në apartamentin e blerë nga ana ime dhe e bashkëshortit në \*\*\*, Tiranë...”*. Subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar këtë adresë banimi në D.V. 2011 dhe 2012.
- 16.7 Subjekti në përgjigje të email-it të datës 16.5.2019, dërguar nga Komisioni, e pyetur mbi mënyrën e fitimit të kredisë, për sa lidhet me deklaratimet e subjektit mbi vendbanimin, ndër të tjera, deklaroi se: *“...Në atë kohë, për shkak të marrëdhënieve të mia të punësimit dhe për shkak të rrethanave familjare (djali im ishte një vjeç e gjysmë), nga shtatori i vitit 2012, pasi më mbaroi periudha e komandimit në Prokurorinë e Durrësit dhe jam rikthyer të punoj në Prokurorinë e Fierit (pra në vendin ku kisha emërimin), ne menduam të banonim në qytetin e Fierit”*.
- 16.8 **Nga aktet në dosjen e kredisë në \*\*\***<sup>18</sup>, rezulton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vërtetimin datë \*\*\*.2.2013, vërteton se: *“Nga verifikimi i regjistrave të kësaj gjykate nuk rezulton të ketë proces penal në ngarkim të znj. Manjola Kajana/ \*\*\*,\*\*\*, banues në Fier nga data \*\*\*.1.2010 deri më sot, datë \*\*\*.2.2013”*. Po ashtu Bashkia Fier, Njësia Administrative nr. \*\*\*, me vërtetimin e datës \*\*\*.3.2013, ka vërtetuar: *se shtetasi \*\*\*,\*\*\*, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, është banor në lagjen “\*\*\*”, të kësaj Njësie Administrative, Fier. Në këtë praktikë gjendet e administruar dhe certifikata familjare e datës*

---

<sup>16</sup> Subjekti i rivlerësimit sqaron se: *“Në vitin 2014 mbaj mend kemi transferuar gjendjen civile në qytetin e Durrësit, me adresë: lagjen nr. \*\*\*, rruga “\*\*\*.\*\*\*”, Durrës. Në këtë adresë nuk kemi banuar, por ky regjistrim/transferim është bërë për ta përdorur si adresë për shkak të babait të bashkëshortit, i cili vazhonte të punonte në Durrës (mësues në shkollën 9-vjeçare “\*\*\*”, Durrës) dhe për shkak se ishte në prag pensioni, dhe kishte lehtësi veprimesh administrative në qytetin e Durrësit. Kjo adresë i përket shtetasit \*\*\*,\*\*\*, i cili është shok me bashkëshortin tim, \*\*\*,\*\*\*. Pra nuk kemi jetuar në këtë adresë, por kjo adresë është përdorur për t’u regjistruar në Gjendjen Civile në qytetin e Durrësit”*. Referohuni përgjigjeve të subjektit në pyetësorin nr. 1.

<sup>17</sup> Sjellim në vëmendje që Vendimi i Këshillit Bashkiak të Bashkisë Fier është marrë në datë \*\*\*.10.2012.

<sup>18</sup> Referohuni vërtetimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, datë \*\*\*.2.2013, pjesë e dokumentacionit të kredisë, pranë \*\*\*.

\*\*\*.3.2013, lëshuar nga Gjendja Civile Fier, në të cilin figurojnë katër persona, subjekti i rivlerësimit, bashkëshorti, i biri dhe vjehri i saj.

16.9 **Nga aktet në dosjen e EKB-së** për privatizimin e banesës në Durrës, rezulton se: “... gjendja familjare e muajit mars për vitin 2011, për shtetasin \*\*\*.\*\*\* (vjehri i subjektit) ka qenë e përbërë nga katër persona, ku përfshihen \*\*\*.\*\*\*, \*\*\*.\*\*\*.\*\*\*, \*\*\*.\*\*\*.\*\*\* dhe \*\*\*.\*\*\*.\*\*\* (1 vjeç në atë kohë), sipas vërtetimit të lëshuar nga zyra e Gjendjes Civile nr.\*\*\*, Bashkia Durrës”. Ndërkohë, bazuar në të dhënat e certifikatës familjare të datës \*\*\*.4.2012, lëshuar nga Gjendja Civile Durrës, subjekti, bashkëshorti dhe i biri figurojnë në certifikatë veçmas ndaj vjehrit të subjektit, me shënimin se: “...me dokumentin nr. prot.\*\*\*, datë \*\*\*.11.2011, është bërë ndarja familjare”.

16.10 **Komisioneri Publik, sa më sipër, vlerëson se:** subjekti i rivlerësimit nuk ka plotësuar saktë Deklaratën për Kontrollin e Figurës, sipas shtojcës 3, të ligjit nr. 84/2016, pjesa 2, të dhëna për vendin e banimit, në rubrikën: “historiku i adresave të banimit nga 1.1.2012”. Gjithashtu mbeten të paqarta lëvizjet e gjendjeve civile dhe deklarimit të banesave të subjektit të rivlerësimit, të kryera nga kjo e fundit, si për shkak të përfitimit nga privatizimi i EKB-së, për banesën në Durrës të vjehrit të subjektit, ashtu dhe për përfitimin e kredisë si familje e pastrehë në qytetin e Fierit.

## **17. Lidhur me gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit dhe etikën**

17.1 Komisioneri Publik, gjatë trajtimit të vendimit nr. 84/2018, të Komisionit, për një tjetër subjekt rivlerësimi, është njohur me aktet lidhur me kallëzimin e disa qytetarëve të Bashkisë Fier, për paligjshmëri në ushtrimin e detyrës nga funksionarë bashkiakë të Bashkisë Fier, gjatë dhënies së kredive të buta (lehtësuese) për familje të pastreha.

17.2 Nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ të vendimit të sipërcituar, ashtu siç është trajtuar edhe në ankimin përkatës të Komisionerit Publik, në fillim të muajit korrik 2012, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier rezulton të jetë regjistruar kallëzimi penal nr. \*\*\*/2012.

17.3 Me vendimin e datës \*\*\*.7.2012, organi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier ka vendosur mosfillimin e procedimit penal. Kallëzuesit e kanë ankimuar vendimin në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier dhe kjo e fundit, më datë \*\*\*.2.2013, ka prishur vendimin e Prokurorisë Fier, duke urdhëruar kryerjen e veprimeve të nevojshme hetimore.

17.4 Ndërkohë, më datë \*\*\*.10.2012, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier kishte urdhëruar regjistrimin e procedimit penal nr. \*\*\*, për veprën penale “Shpërdorim të detyrës”, kryer në bashkëpunim, dhe veprën penale të “Falsifikimit të dokumenteve”, për fakte të njëjta, në ngarkim të zyrtarëve të Bashkisë Fier.

17.5 Për këto procedime penale, veprimet hetimore të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier janë shtrirë gjatë harkut kohor 2012 - 2014, ku përfundimisht çështja është dërguar për gjykim për veprën penale: “Shpërdorim detyre” dhe “Falsifikimit të

dokumenteve”. Kjo periudhë përkon me periudhën<sup>19</sup> gjatë së cilës bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e kryefamiljarit, ka ndjekur procedurat për përfitimin nga programi social i strehimit, ndërsa subjekti i rivlerësimit kryente funksionet e prokurores pranë kësaj Prokurorie.

- 17.6 Nisur nga sa më sipër, Komisioneri Publik konstaton se Komisioni, gjatë hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit znj. Kajana, nuk ka hetuar dhe administruar dokumentacion mbi gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit midis subjektit të rivlerësimit në funksionin e prokurorit, në drejtim të përfitimit të një trajtimi preferencial, që mund të përbëjë një konflikt interesi, qoftë dhe në dukje me Bashkinë Fier.
- 17.7 Komisioneri Publik konstaton se mbetet i pahetuar fakti nëse subjekti i rivlerësimit të ketë përfituar statusin e pastrehë, që rezulton se nuk mund ta përfitonte bazuar në kërkesat e ligjit nr. 9232/2004, “Për programet sociale të strehimit për banorët e zonave urbane”, për shkak të funksionit që ajo kryente në organin e Prokurorisë, që po hetonte zyrtarët e Bashkisë Fier, për të njëjtat shkelje të ligjit.
- 17.8 Po ashtu, referuar kontratës nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.3.2014, “Ndryshime në kontratën e kredisë bankare”, lidhur midis subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj dhe \*\*\*, rezulton se në kredinë e disbursuar më datë \*\*\*.3.2014 është aplikuar normë interesi bono thesari, normë kjo, në dukje preferenciale krahasuar me normat e interesit të aplikuar nga kjo bankë në aneksin bashkëlidhur kontratës së kredisë, së datës \*\*\*.6.2013 (bono thesari vjetore 3.8% + 2.2%). Edhe në këtë rast, nuk rezulton që Komisioni të ketë hetuar mbi gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit midis subjektit të rivlerësimit në funksionin e prokurorit, në drejtim të përfitimit të kësaj norme preferenciale nga \*\*\*.
- 17.9 Komisioneri Publik, sa më sipër, vlerëson se: rezultatet e hetimit administrativ duhet të qartësonin nëse subjekti i rivlerësimit ndodhet ose jo në kushtet e konfliktit të interesit, duke verifikuar nëse subjekti i rivlerësimit ka hetuar apo kryer veprime procedurale, në çështje lidhur me Bashkinë Fier ose zyrtarë të saj, si dhe me \*\*\* ose punonjës të saj. Këto rrethana të ndërthurura me njëra-tjetrën, eventualisht do të qartësonin nëse veprimi apo mosveprimi i subjektit të rivlerësimit ka cenuar rregullat etike profesionale, figurën e magjistratit, e për rrjedhojë, besimin e publikut, referuar nenit 61, pika 5, e ligjit nr. 84/2016.

## **18. Çështje të tjera lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të**

### **18.1 Mbi të ardhurat e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit për vitet 2013 - 2014**

- 18.1.1 Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e personit të lidhur, ka deklaruar në D.V. 2013 dhe D.V. 2014 të ardhura nga paga pranë shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k, respektivisht në shumat 600.000 lekë për vitin 2013 dhe 150.000 lekë për vitin 2014,

<sup>19</sup> Referohuni shkresës nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.6.2019, të Bashkisë Fier.

shuma të cilat rezultojnë të jenë depozituar në llogarinë e pagës së bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, pranë bankës \*\*\*.\*\*\*.\*\*\*<sup>20</sup>.

- 18.1.2 Instituti i Sigurimeve Shoqërore, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.11.2018, ka informuar Komisionin mbi pagat e deklaruara, palët punëdhënëse, si dhe kontributet e derdhura për efekt pensioni pleqërie për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të. Në informacionin e dërguar nuk ka të dhëna për bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit, për periudhën dhjetor 2012 - maj 2015.
- 18.1.3 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetjeve të Komisionit mbi këtë fakt, ndër të tjera, ka shpjeguar se: *“...Në muajin prill të vitit 2019, nga ana e administratorit të kësaj kompanie, na është thënë se ... ata janë përballur me një gabim njerëzor, si dhe është bërë e mundur pagesa e detyrimeve për tatimin mbi fitimin për atë periudhë. Në të njëjtën kohë na janë dorëzuar dy urdhërpagesa të “\*\*\*” sh.p.k, me nr. NIPT \*\*\*, me përshkrimin ‘pagesë kundrejt detyrimit tatimor’, ku njëri urdhër mban shumën 38.538 lekë dhe tjetri 139.008 lekë<sup>21</sup>”.*
- 18.1.4 Bashkëngjitur këtyre shpjegimeve, subjekti ka depozituar: (i) Urdhërpagesë 1500, tatim i mbajtur në burim, periudha tatimore korrik 2015, shuma 38.538 lekë; (ii) Mandat pagese i datës \*\*\*.4.2019, që vërteton pagesën e shumës 38.538 lekë nga llogaria e shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k.; (iii) Urdhërpagesë 1500, tatim i mbajtur në burim, periudha tatimore dhjetor 2014, shuma 139.008 lekë; (iv) Mandat pagese i datës \*\*\*.4.2019, që vërteton pagesën e shumës 139.008 lekë nga llogaria e shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k.
- 18.1.5 Komisioni, bazuar në këto akte, ka vlerësuar se: *“Sipas kontratës individuale të depozituar rezulton se kontributet mbi të ardhurat e përfituara nga punësimi i bashkëshortit të subjektit do të derdheshin nga punëdhënësi. Sipas statement-it bankar, Komisioni konstatoi se pagat e bashkëshortit të subjektit në shumën 50.000 lekë ishin kaluar çdo muaj në sistemin bankar nga punëdhënësi, ndërsa u konstatua se nuk ishin paguar kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për këtë periudhë punësimi... Në këto kushte, Komisioni i përfshiu këto të ardhura në analizën financiare<sup>22</sup>”.*
- 18.1.6 Në vlerësim të Komisionerit Publik, aktet si më sipër, nuk provojnë pagesën e detyrimeve tatimore për të ardhurat nga punësimi pranë kompanisë “\*\*\*” sh.p.k., në konsideratë të nenit D, pika 3, e aneksit të Kushtetutës, pasi:
- i. Referuar Kontratës individuale të punësimit datë \*\*\*.1.2013, midis shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k. dhe z.\*\*\*.\*\*\*, të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, rezulton se bashkëshorti i saj ka qenë i punësuar pranë kësaj shoqërie në pozicionin jurist/konsulent ligjor. Në dispozitën “Kushtet e pagesës” është parashikuar detyrimi i punëdhënësit për të

<sup>20</sup> Referohuni shkresës nr.\*\*\* prot., datë \*\*\*.12.2018, e bankës “\*\*\*.\*\*\*.\*\*\*”.

<sup>21</sup> Referohuni shpjegimeve të subjektit, në përgjigje të pyetësorit të Komisionit, të datës 23.4.2019.

<sup>22</sup> Referohuni “Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm”, faqe nr. 8, në vendimin e Komisionit.

*derdhur në llogari të punëmarrësit kuotën e përcaktuar sipas ligjit në fuqi për tatimet dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore.*

- ii. Bazuar në këtë kontratë dhe në konfirmimin nga ISSH-ja (paragrafi 18.1.2, më sipër), rezulton se nuk është shlyer detyrimi i punëdhënësit mbi tatimin mbi të ardhurat personale dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- iii. Në formularin e periudhës tatimore *korrik 2015*, në detajet e urdhërpagesës është specifikuar: *“Tatim mbi të ardhurat nga dividendë dhe aksione”*, dhe shuma e detyrimit e gjeneruar nga sistemi dhe e paguar më datë *\*\*\*.4.2019*, i përket vetëm gjobave dhe interesave të shoqërisë ndaj organeve tatimore për këtë periudhë, për këtë zë.
- iv. Në formularin e periudhës tatimore *dhjetor 2014*, në detajet e urdhërpagesës është specifikuar: *“Të tjera tatime në burim, detyrim principali”* dhe shuma e gjeneruar nga sistemi dhe e paguar më datë *\*\*\*.4.2019*, nuk duket se i korrespondon detyrimit të tatimit mbi të ardhurat personale për pagën e përcaktuar në kontratën e punës të datës *\*\*\*.1.2013*, së bashku me gjobë dhe interesa, deri në datën e gjenerimit të urdhërpagesës nga sistemi tatimor.
- v. Në të dyja urdhërpagesat e vëna në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit, nuk rezulton që detyrimet e gjeneruara nga sistemi tatimor të lidhen me sa detyrohej shoqëria sipas kontratës individuale të punësimit të datës *\*\*\*.1.2013*. Tatimi i paguar nga kjo shoqëri në datën *\*\*\*.4.2019*, rreth 6 vite me vonesë nga lindja detyrimit, nuk korrespondon me detyrimin e shoqërisë për tatimin mbi të ardhurat personale nga paga e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, të realizuara gjatë periudhës janar 2013 - mars 2014, as për llojin e tatimit të paguar, as për periudhën tatimore të përcaktuar në urdhërpagesë dhe as për shumën e paguar.

18.1.7 *Komisioneri Publik, sa më sipër, vlerëson se për këto shkaqe, këto të ardhura, nuk duhet të llogariteshin nga ana e Komisionit si burime të ligjshme të të ardhurave të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj.*

## **18.2 Mbi kursimet nga pagat, deklaruar si burim i krijimit të pasurisë apartament 110 m,<sup>2</sup> me adresë: *\*\*\*, Tiranë***

18.2.1 Lidhur me këtë pasuri, subjekti ka deklaruar si burim krijimi: (i) kursimet e realizuara nga paga e subjektit të rivlerësimit dhe e bashkëshortit të saj në vite dhe (ii) pjesërisht me kredi nga *\*\*\**<sup>23</sup>.

18.2.2 Komisioni, në vendimin e tij, ka konkluduar: *“në lidhje me këtë pasuri, Komisioni kreu analizën financiare për burimet e ligjshme për blerjen e pasurisë, duke përllogaritur kursimet e krijuara nga të ardhurat nga pagat e subjektit dhe të bashkëshortit të saj, të*

<sup>23</sup> Burimi i krijimit: (ii) nga kredia bankare, është trajtuar gjerësisht më sipër nga pika 14 e në vijim.

*ardhurat nga kredia, si dhe shpenzimet e kryera. Në konkluzion Komisionit i rezultoi se subjekti ka pasur burime të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie”<sup>24</sup>.*

- 18.2.3 Mbi burimin e krijimit: (i) *kursime nga paga*, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentacion provues mbi shlyerjen e kësteve të apartamentit<sup>25</sup>. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, hetimi i Komisionit mbi krijimin e depozitave që kanë shërbyer si burim për pagesat e apartamentit, nuk ka qenë i plotë.
- 18.2.4 Nga verifikimi i dokumentacionit nga bankat e nivelit të dytë mbi llogaritë e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, rezulton se nga depozita pranë \*\*\* Bank, në datën \*\*\*.4.2013, është tërhequr në *cash* shuma 4.350 euro dhe në datën \*\*\*.6.2013 është tërhequr në *cash* shuma 16.800 euro. Të dyja këto tërheqje korrespondojnë me datat e pagesës së kësteve të apartamentit.
- 18.2.5 Për sa i përket burimit të krijimit të kësaj depozite, nga verifikimi i deklarimeve vjetore të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj, si dhe nga verifikimi i lëvizjeve në llogaritë bankare, rezulton se: Kjo depozitë është çelur në datë \*\*\*.8.2009, nëpërmjet veprimit derdhje *cash* të shumës 12.000 euro, nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, në \*\*\* Bank. Në D.V. 2009, subjekti ka deklaruar çeljen e depozitës së bashkëshortit të saj, në shumën 12.000 euro, pranë \*\*\* Bank<sup>26</sup>.
- 18.2.6 Në D.V. 2010, subjekti ka deklaruar shtesë të depozitës ekzistuese në emër të bashkëshortit, e cila në 31.12.2010 rezulton në shumën 15.085 euro.
- 18.2.7 Në D.V. 2011, subjekti rivlerësimit ka deklaruar, ndër të tjera, “...depozitë në emër të bashkëshortit të saj, në vlerën 21.005.5 euro”. Nga verifikimi i lëvizjeve të llogarive bankare pranë \*\*\* Bank, rezulton se kjo depozitë është krijuar nga bashkimi i depozitës ekzistuese, deklaruar në D.V. 2010 me depozitën e re, nr. \*\*\*, të çelur në \*\*\* Bank, në datë 18.1.2011, në të cilën rezulton veprimi derdhje *cash*, në datë 18.1.2011, shuma prej 2.000 euro.
- 18.2.8 Ky depozitim nuk mbulohet me burime të ligjshme të subjektit të rivlerësimit, pasi të ardhurat nga paga e subjektit dhe personave të lidhur me të, deri më këtë datë, janë në shumën 274.877 lekë<sup>27</sup>. Deri në momentin e depozitimit të shumës 2.000 euro, në datë 18.1.2011, janë tërhequr nga llogaritë vetëm 126.000 lekë, të cilat nuk janë të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet dhe kursimin e depozituar në bankë.

<sup>24</sup> Referohuni “Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm”, faqe nr.11, në vendimin e Komisionit.

<sup>25</sup> Në datën \*\*\*.4.2013 është depozituar shuma prej 4.310 euro në llogarinë e noterit në \*\*\*; në datë \*\*\*.6.2013, shuma prej 18.000 euro, në llogarinë e shitësit pranë Bankës \*\*\*.\*\*\*; në datë \*\*\*.03.2014, në llogarinë e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, pranë \*\*\* është disbursuar kredia në shumën 2.500.000 lekë, e cila (pas zbritjes së komisioneve bankare) në të njëjtën datë, është transferuar në llogarinë bankare të shoqërisë shitëse; në datë \*\*\*.8.2013, shuma 50 euro; në datë \*\*\*.6.2014, shuma 2.000 euro; në datë \*\*\*.6.2014, shuma 1.200 euro; në datë \*\*\*.7.2014, derdhur shuma 20 euro; pagesa në llogarinë e shoqërisë shitëse pranë bankës \*\*\*.\*\*\*.

<sup>26</sup> Lapsus në deklarim, depozita është në \*\*\* Bank.

<sup>27</sup> Paga e subjektit të rivlerësimit, kaluar në llogarinë pranë \*\*\*, në shumën 79.438 lekë, paga e bashkëshortit të subjektit kaluar në llogarinë pranë \*\*\*, në shumën 153.360 lekë, si dhe paga e vjehrrit të subjektit 42.079 lekë, sipas lëvizjeve të llogarisë së tij pranë \*\*\* Bank.



18.2.9 Në të njëjtën depozitë rezulton se në datë \*\*\*.4.2011 është depozituar edhe shuma 5.000 euro, derdhe *cash*. Depozitimet në total deri në datë \*\*\*.4.2011, në shumën 7.000 euro, nuk rezultojnë të mbulohen plotësisht me të ardhura të ligjshme të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, për një diferencë negative prej rreth 115.000 lekë, nëse llogarisim në përbërje familjare dhe vjehrrin e subjektit të rivlerësimit ose rreth 252.000 lekë, nëse nuk përfshijmë vjehrrin e subjektit në përbërjen familjare të saj<sup>28</sup>.

18.3 *Komisioneri Publik, sa më sipër, vlerëson se:* nuk është hetuar nga Komisioni mbi mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, për të mbuluar me burime të ligjshme, shpenzimet dhe kursimet në sistemin bankar.

#### **IV. Kërkimi i ankimit**

19. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik në procesin e rivlerësimit, ka të drejtën dhe detyrimin e ushtrimit të kontrollit ndaj vendimeve të dhëna nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, duke vlerësuar nëse vendimmarrja bazohet në një hetim të plotë dhe të gjithanshëm dhe çmim të drejtë të provave të administruara;

20. Në konsideratë të trajtimit të shkaqeve të ankimit, bazuar në parashikimet e nenit 179/b/5 të Kushtetutës, nenit C/2, Ç dhe F/7, të aneksit të Kushtetutës, nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, ndryshe nga sa disponon Komisioni i Pavarur i Kualifikimit në vendimin nr. 162, datë 19.6.2019, referuar gjendjes së fakteve dhe provave, Komisioneri Publik nuk krijon bindjen se në rastin konkret, në analizë të të tria kriterëve të rivlerësimit, gjen zbatim neni 59/1 i ligjit nr. 84/2016;

21. Mbështetur në parashikimin e nenit F, pika 3 dhe 7 e aneksit të Kushtetutës, nenit 66 të ligjit nr. 84/2016, kërkohet që shkaqet e parashtruara në këtë ankim të merren në konsideratë nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe, pas vlerësimit tërësor të procedurave, për subjektin e rivlerësimit, znj. Manjola Kajana, në përfundim të gjykimit të çështjes, të vendosë:

- *Ndryshimin*

*ose*

- *Lënien në fuqi të vendimit nr.162, datë 19.6.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.*

**KOMISIONERI PUBLIK**

**Florian BALLHYSA**

---

<sup>28</sup> Në llogaritje janë përfshirë të ardhurat nga pagat sipas kalimeve në llogaritë bankare deri në datën \*\*\*.4.2011, tërheqjet nga llogaritë deri në këtë datë, ndryshimi i balancave në llogaritë e pagave të subjektit të rivlerësimit, bashkëshortit dhe vjehrrit të saj, për datat \*\*\*.4.2011 dhe \*\*\*.12.2010, si dhe kursimet/shtesat e depozitës pranë \*\*\* Bank, të konvertuara me kursin e këmbimit në datën e depozitimeve.